



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

K Ë R K E S Ë

**PËR VENDOSJEN E MASËS SË SIGURIMIT PASUROR
TË SEKUESTROS PREVENTIVE MBI LLOGARITË BANKARE**

- Drejtuar :** Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan
- Kërkues :** Prokuroria e pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, përfaqësuar nga prokurori Kreshnik Ajazi
- Objekti :** Vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive të llogarive bankare
- Baza Ligjore :** Neni 274 i Kodit të Procedurës Penale

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimi penal nr.602, viti 2015, për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të personit nën hetim Flamur Bali.

Nga aktet e këtij procedimi rezulton se shërbimet e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan kanë referuar materialet në ngarkim të shtetasit Flamur Bali. Nga të dhënat e policisë gjyqësore rezulton dyshimi se shtetasi në fjalë ka kryer transaksione të pajustificuara dhe ka në disponim pasuri me burime të dyshimta. Informacioni është poseduar në rrugë ligjore nga një institucion shtetëror kompetent. Sipas të dhënave të para, rezulton se shtetasi Flamur Bali ka përfituar në periudhën 2012-mars 2015 në emër të tij dhe të bashkëshortes së tij disa shuma të konsiderueshme të hollash që shkojnë me vlerë deri në 99.384 GBP, nëpërmjet transaksionesh bankare të copëzuara. Rezulton se dërgues të këtyre shumave të jenë shtetasit shqiptar Florjan Merko dhe Erjon Muça si dhe shtetasja estoneze Katren Ivask, të cilët janë banues në shtetin anglez. Nga të dhënat e para

hetimore ka rezultuar se shtetasi Florjan Merko është i dënuar për ndihmë në kalimin e paligjshëm të kufirit nga autoritetet gjyqësore angleze. Rezulton se transaksionet bankare janë kryer në bankën e nivelit të dytë "ALPHA".

Bazuar nga sa më sipër si dhe në tërësinë e veprimeve hetimore të deritanishëm vlerësojmë se është e nevojshme vendosja e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi llogaritë bankare pranë Bankës "Alpha Bank" në emër të personit nën hetim Flamur Bali. Vendosja e kësaj mase është e nevojshme pasi lënia e lirë e transaksioneve mbi këto llogari bankare krijon mundësinë e tjetërsimit, ndryshimit dhe fshehjes së këtyre llogarive bankare dhe të shumave të parave në to si dhe krijon mundësinë e kryerjes së zgjatjes dhe rëndimit të pasojave të veprës penale.

Për këto arsye dhe në bazë të neneve 274 e vijues të K.Pr.Penale,

KËRKOJMË:

1. Vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi të gjitha llogaritë bankare pranë bankës "ALPHA Bank" në emër të personit nën hetim Flamur Alush Bali, dtl.19.07.1978.
2. Një kopje e vendimit të gjykatës t'i vihet në dispozicion subjektit që administron objektet e sekuestrimit.
3. Me ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohen shërbimet e policisë gjyqësore pranë DPQ Elbasan.

PROKURORI

KRESHNIK AJAZI

Kërkesës i bashkangjitet tërësia e akteve procedurale të fashikullit nr.602, viti 2015.